



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 31.05.2024		
Mjësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-350/05-26928		



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Për: Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Lënda: Dërgimi i Informatës lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031

Përmes këtij akti, ju dërgojmë shkresën informuese për Kuvendin e Komunës së Lipjanit lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031.

Propozoj që këtë Informatë ta përfshini në rendin e ditës për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës në muajin qershor 2024.

Shtojcë:

Informata lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031.

Me respekt,

Lipjan, 31.05.2024



Imri Semetishtti

DRUMM



Për: Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Lënda: Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031

Të nderuar Asambleistë të Kuvendit të Komunës së Lipjanit!

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës të datës 26.04.2022 për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) për periudhën 2023-2031, si dhe duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, Komuna e Lipjanit ka hartuar projekt Planin Zhvillimor Komunal dhe Raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për PZHK.

Praktikisht, kemi zhvilluar të 4 fazat e hartimit të PZHK-së, duke përfshirë:

1. Profilin e Komunes¹;
2. Vlerësimin e Gjendjes² (përgatitja e swot analizës)
3. Kornizën e Zhvillimit Hapësinor³ (*vizioni, qëllimet dhe objektivat strategjike*); dhe
4. Prioritetet Strategjike Zhvillimore dhe Planin e Veprimit.

Duke iu referuar dispozitave ligjore, gjatë procesit të hartimit të PZHK, janë marr parasysh dokumentet si:
- Strategjitë sektoriale, afatshkurtra në nivel lokal dhe qendror, që i referohen fushave si: Demografia; Ekonomia; Infrastruktura Teknike, Publike dhe Sociale; Mjedisi; Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore; Banimi; etj.

- Strategjitë nga planet e mëhershme të nivelit komunal – Plani Zhvillimor Komunal në fuqi 2013-2023;
- Strategjitë e Komunave fqinje – strategjitë dhe skenarët e zhvillimit hapësinor të komunave fqinje;
- Përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit si në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+. Komuna e Lipjanit brenda Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) trajtohet në zonën e kaltër, specifikisht si Porti i Kosovës, i cili përmban udhëzime dhe sfida që duhen përfshirë në dokumentet e planifikimit të nivelit lokal, në rastin konkret në Planin Zhvillimor të Komunës së Lipjanit, i cili në peripikmëri i është përmbajtur zhvillimeve të planifikuara sipas PHK dhe Strategjisë së Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+.

¹ Për këtë fazë konsultimi publik ka filluar me datën 11 janar 2023

² Për këtë fazë konsultimi publik ka filluar me datën 14 prill 2023

³ Për këtë fazë konsultimi publik ka filluar me datën 27 qershor 2023

Gjatë procesit të hartimit të PZHK, si dokument i planifikimit hapësinor, është inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrja e publikut në procesin e hartimit të këtij dokumenti të planifikimit hapësinor, nga të cilat derivon përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave specifike, duke konsultur gjithashtu qëllimet dhe objektivat e planeve strategjike të nivelit lokal dhe qendror, me bazë mbi analizën e gjendjes ekzistuese.

Gjatë hartimit të PZHK-së, janë mbajtur konsultime periodike me ekipin bazë dhe ekipin komunal të planifikimit për hartimin e PZHK-së, janë organizuar aktivitete të vazhdueshme të grupeve punuese, institucioneve dhe organizatave të sektorit publik dhe privat dhe të gjithë qytetarëve të interesuar, për qëllime hulumtimi, analizimi dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme gjithëpërfshirëse. Mbi këtë bazë është hartuar Vizioni i Komunës së Lipjanit, i cili definon shtyllat kryesore strategjike si: ekonomia e qendrueshme, TZHEK, cilësia e jetesës dhe mjedisi i pastër.

Për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave zhvillimore të Komunës së Lipjanit, në PZHK-në e hartuar, përveç tjerash janë harmonizuar zhvillimet me dispozitat nga: Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+, Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm, Agjenda e BE-së dhe Karta e Leipzig.

Qëllimet dhe objektivat janë përcaktuar për secilën fushë tematike (4.5.1), me theks fusha e Infrastrukturës Teknike, Qëllimi 4.5.1.2, përcaktuar në Qëllimin I - Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave, e trajtuar në kuadër të 5 Objektivave Specifike.

Për të tri fazat e para⁴ janë mbajtur konsultimet publike sipas legjislacionit në fuqi dhe në të gjitha këto konsultime janë ftuar edhe zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Për të gjitha fazat materialet janë publikuar në faqen zyrtare të Komunës. Gjatë gjithë procesit janë marrë në konsideratë të gjitha propozimet, sygjerimet dhe komentet nga publiku.

Pas hartimit të fazës së IV-të “Prioritetet Strategjike Zhvillimore dhe Plani i Veprimit”, sipas kërkesave ligjore kemi hartuar Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për të cilin raport po ashtu janë mbajtur konsultimet publike prej 30 ditësh⁵ dhe po ashtu janë bërë publike të gjitha materialet.

Periudha e konsultimit publik ka përfunduar me 10 nëntor 2023, kurse me datën 13 nëntor 2023 kemi dorëzuar Raportin për VSM në organet kompetente të MMPHI-së për marrjen e pëlqimit. Si rrjedhojë e këtij procesi, hartimi i PZHK-së dhe VSM-së ka kaluar të gjitha fazat, si në aspektin ligjor ashtu edhe atë teknik, dhe në konsultim me të gjithë akterët relevant është finalizuar në nivel të Draftit.

Duke pasur parasysh kalimin e afateve ligjore për përgjigje, si dhe pas disa kontakteve të zhvilluara në MMPHI, me datën 15 janar 2024, Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit dhe të Ujërave (DMMU) ka kërkuar plotësimin e Raportit të VSM-së me listën për Zonat e Mbrojtura dhe ndryshimet nga PZHK aktuale në PZHK e re. Të dhënat e kërkuara janë plotësuar dhe janë dërguar brenda 3 ditësh. Lidhur me këte, DPUMM në bashkëpunim me DMMU ka organizuar takim të përbashkët lidhur me Raportin dhe të dhënat e kërkuara. Në këtë takim është konstatuar se janë plotësuar të gjitha të dhënat që i referohen raportit të VSM-së për PZHK-në.

⁴ 1. Profili i Komunes; 2. Vlerësimi i Gjendjes; dhe 3. Korniza e Zhvillimit Hapësinor

⁵ Raporti për VSM dhe mbajtja e konsultimit publik për VSM është kërkesë ligjore

Pas krejt kësaj periudhe, Komisioni përkatës i MMPHI-së është takuar me datën 8 mars 2024 ku ka shqyrtuar Raportin e VSM-së. Në këtë rast, Komisioni ka marr vendim se Raporti i VSM-së i plotëson të gjitha kriteret për PZHK dhe i propozon Ministrin dhënien e pëlqimit për Raportin e VSM-së.

Nga data 8 mars 2024, disa herë e kemi kontaktuar MMPHI-në lidhur me pëlqimin për VSM por çdo herë kemi marr përgjigjen se çështja është te Ministri.

Përfundimisht me datën 14 maj 2024 kemi pranuar një email nga DMMU ku informohemi se: citim- ***“Komisioni për VSM në takimin e fundit ka konstatuar se kërkesa e Komunës së Lipjanit për pajisje me Pëlqim Mjedisor të VSM-së për PZHK, nuk është në përputhje me Planin Hapësinor të Republikës së Kosovës. PZHK e Komunës së Lipjanit nuk e ka trajtuar fare planifikimin për ndërtimin e Deponisë së re regjionale, andaj për të vazhduar me procedimin e kërkesës tuaj, kërkojmë nga ju që te na sjellni raportin e rifreskuar së bashku me PZHK, ku do të jetë e paraparë edhe ndërtimi i deponisë së re”*** – përfundim i citatit.

DPUMM në koordinim edhe me kompaninë konsulente të kontraktuar, ka pasur kujdes të veçantë që gjatë hartimit të PZHK-së çdo gjë të jetë në përputhje me dokumentet e nivelit nacional. Një verifikim të detyrimeve që dalin nga PHK e kemi bërë edhe njëherë së bashku me kompaninë konsulente.

Pretendimi i MMPHI se PZHK nuk është në përputhje me PHK sepse nuk është përfshirë ndërtimi i deponisë së re regjionale nuk qëndron, pasi që një deponi e tillë në territorin e Komunës së Lipjanit nuk është planifikuar me PHK, prandaj konsiderojmë se të gjitha dispozitat e parapara në PHK 2010-2020+ janë përfshirë në PZHK-n e dorëzuar.

Sa i përket ndërtimit të deponive, seksioni “Deponitë e Mbeturinave” pika 1.1.6.5 në PHK përmban një përshkrim të detajuar të trajtimit të mbeturinave dhe të deponive ekzistuese dhe të planifikuara në Kosovë. Në këtë seksion theksohet se procesi i grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave kryhet nga ndërmarrjet publike komunale, nga disa kompani private dhe OJQ. Aktualisht, në Kosovë operojnë 30 ndërmarrje publike komunale dhe 8 kompani private në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Nga 30 komunitat e Kosovës, 26-prej tyre kanë pasur deponi komunale që janë përdorur për shumë vite. Me ndihmën e MMPHI, AKM⁶ dhe komunave përkatëse, disa prej këtyre deponive janë mbyllur, kurse disa të tjera janë rehabilituar. Megjithatë, në përshkrimin e deponive të reja të ndërtuara apo në ndërtim e sipër, Plani Hapësinor i Kosovës nuk përmend ndërtimin e një deponie të re në Lipjan. Vendet ku deponitë e reja janë ndërtuar apo janë në ndërtim, përfshijnë Gjiljanin, Pejën, Besianën, Mitrovicën, Fushë Kosovën, Kaçanikun, Prizrenin, Dragashin dhe Zveçanin.

Lidhur me shkresën dhe referencën e DMMU të datës 14 maj 2024 për mospërfshirjen e deponisë regjionale në PZHK të Komunës së Lipjanit, DPUMM i ka kthyer përgjigje atij departamenti me datën 22 maj 2024 duke e kontestuar bazueshmërinë e shkresës së tyre me një mori faktesh relevante. Deri më tani në kemi pranuar ndonjë reagim kthyes në shkresën e DPUMM-së.

Pas shkresës së MMPHI-së, jemi në situatë të “ngrirë” për zhvillimin e këtij projekti. Kjo situatë nuk mund të qëndroj gjatë, përveç tjerash edhe për shkak të obligimeve kontraktuale që kemi ndaj kompanive konsulente.

Nisur nga gjendja aktuale, jemi para dy alternativave të mundshme:

⁶ Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, tani Agjencia Kosovare e Privatizimit.

- Përfshirja e deponisë regjionale në PZHK dhe Raportin e VSM, ku përveç tjerash si pasojë e çdo ndryshimi apo plotësimi në këtë fazë i referohet kthimit të procesit në gjendjen fillestare; ose
- Shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës për iniciimin e hartimit të PZHK-së të datës 26.04.2022.

Qëllimi i kësaj shkrese informuese është sa për të qartësuar ngecjen e procesit në finalizimin e PZHK-së.

Komuna e Lipjanit do të jetë në dispozicion të vazhdueshëm dhe në bashkëpunim të ndërsjellë për tejkalimin e kësaj situate, me qëllim të finalizimit të dokumentit të PZHK-së si dokument me rëndësi të veçantë për Komunën. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat aktuale, kompanitë konsulente kanë shprehur mirëkuptim për vazhdimin e kontratave deri në fund të vitit 2024.

Lipjan, 31.05.2024

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës

